



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality of Rahovec



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kultur, Omladinu i Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

13 Nr. Zyrtar – 2021

Dt.: 23.04.2021

Nr. l prot. 1635 Më 23.04.2021
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-48, për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L - 222 dhe Ligjit Nr.04/L -116 nenit 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr.03/L-040,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës,28/2008), nenit 5,7 dhe 8 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve Nr.1427 e datës 28.04.2017, dispozitat e nenit 8, 10, 12 dhe 16 të Rregullores MF-Nr 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 74, dhe nenit 92, paragrafi 4, të statutit të Komunës Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe Thirrjes Publike të datës 12.03.2021, bazuar në Vendimin Nr.221/187 të datës 07.04.2021, për formimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e Aplikacioneve për ndarjen e Subvencioneve në Kulturë dhe Rini nga DKRS-ja për vitin 2021, Komisioni Vlerësues nxjerr këtë:

VENDIM

1. Në përputhje me afatet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues, të përcaktuara me rregulloret e lartëcekura dhe vendim të Kryetarit të Komunës, dhe mbi bazën e thirrjes publike të datës 12.03.2021, Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha aplikacionet dhe dokumentacionin përkatës të dërguar nga OJQ – të, ku sipas kriterëve, Komisioni Vlerësues ka shpallur fitues për Subvencionim këto OJQ në Kulturë dhe Rini.

LISTA PRELIMINARE E PËRFITUESËVE NGA SUBVENCIONET NË SEKTORIN E KULTURËS DHE RINISË- 2021

Nr.	EMRI I OJQ /INDIVIDËVE TË REGJISTRUAR	TITULLI I PROJEKTIT	BARTËSI I PROJEKTIT	NUMRI I PROTOKOLIT	ADRESA
1.	ART STUDIO	20 –Vjet Art Colony	Selami Haxhijaha	1260	Rahovec

2.	KUVENDI I TË RINJËVE TË KOSOVËS	Edukimi i të rinjve nëpërmjet trashëgimisë kulturore dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore	Qëndrim Tara	1331	Rahovec
3.	FONDI PËR EDUKIM KULTUROR DHE TRASHËGIMI	Festivali Ndërkombëtar i Poezisë "Poezia dhe vera" Edicioni V-të	Fahredin Shehu	1132	Rahovec
4.	ART MUZA	Botimi i monografisë për Dëshmorin "Mizahir Isma" – "Shqiponjat se braktisin folenë"	Hazir Luta	1316	Radostë
5.	QENDRA KULTURORE ARTISTIKE "JEHONA E ANADRINIT"	20-Vjet Traditë "ANADRINIA JEHON 2021"	Salih Bytyqi	1215	Dejnë
6.	SHKA BAJRAM CURRI	Ruajtja e vlerave Kombëtare	Fatmir Sejfullahu	1325	Krushë e Madhe
7.	TRADITA SHQIPTARE ANADRINI	Ruajtja dhe kultivimi i vlerave artizanale të femrave dhe të rinjve në zonat rurale	Servete Kastrati	1258	Zatriq
8.	SHOQATA ARBËRIA	Botimi i dëshmive të luftës dhe mbledhja e të dhënave për dëmet e luftës 1998/1999	Dervish Çadraku	1356	Malësi e Vogë
9.	RINIA MULTITETNIKE E REGJIONIT TË PRIZRENIT	N'konak Rahovecit na bashkon kënga shqipe (Edicioni III)	Naser Dula	1370	Rahovec
10.	KËSHILLI RINOR	Botimi i revistës së poetëve të rinjë	Enis Berisha	1371	Rahovec
11.	SHOQATA KULTURORE ANADRINI	Folklori Anadrinas 2021	Xhafer Bytyqi	1373	Xërxë
12.	OVL-UÇK	Organizimi i manifestimeve për Dëshmorët e Kombit	Feriz Thaqi	1209	Rahovec
13.	SH.K.A "RAHOVECI"	Kultura Anadrinase e dashur për rinin tonë	Fatos Hasku	1312	Rahovec
14.	SHL-KOSOVA	Ngritja e kapaciteteve të të rinjve në Rahovec	Enis Durguti	1110	Rahovec
15.	SHOQËRIA KULTURORE "GANIMETE TËRBESHI"	Subvencionimi i SH.K.A – së "Ganimete Tërbeshi"	Murat Kryeziu	1111	Xërxë
16.	ALBSE	Integrimi i komuniteteve rome, egjiptiane dhe ashkali në komunën e Rahovecit	Bashkim Bytyqi	1344	Rahovec

Pas kalimit të afatit të ankesave dhe të procedurave të tjera të parapara në rregulloret e lartëcekura, Kryetari i Komunës do të nënshkruajë kontratat me përfutjesit e mjeteve financiare me të gjitha OJQ-të.

Arsyetim

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ – të dhe Individ në Kulturë dhe Rini, brenda afatit të përcaktuar dhe në përputhje me rregulloret e lartëcekura si dhe mbi bazën e thirrjes publike të datës 12.03.2021, ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni, ku nga 37 aplikacione të pranuar, kriteret i kanë plotësuar 16 prej tyre dhe janë refuzuar 21 aplikacione për shkak të dokumentacionit jo të kompletuar dhe mos përmbajtjes së kriterëve të Thirrjes Publik.

Refuzimi i aplikacioneve të individëve të cilët kanë aplikuar në thirrjen për Aplikim për subvencionimin në fushën e Kulturës dhe Rinisë është bërë pasi që të njëjtët nuk kanë paraqitur dëshmi se janë të regjistruar si OJQ sipas legjislacionit në fuqi.

Të gjitha palët e pakënaqura me punën e Komisionit për listën finale të lartëcekur nga Kultura dhe Rinia, mund të ushtrojnë ankesë te komisioni për shqyrtimin e ankesave për subvencione në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në afat prej 5 (pesë) ditë pune, nga data e publikimit të kësaj liste finale në tabelën e shpalljeve të Komunës dhe Web-faqen e Komunës.

Udhëzim Juridik: Kundër këtij vendimi lejohet ankesë në afat prej 5 ditësh nga dita e shpalljes së tij në tabelën e shpalljeve dhe në Web-faqen e Komunës. Ankesa parashtrohet pranë Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Ankesave të OJQ –ve dhe Individëve në Komunën e Rahovecit.

- Ankesat dorëzohen me shkrim në sportelin nr.7 në katin e parë në objektin e Komunës.

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve:

1. Shadat Ukaj, kryesues	
2. Muharem Morina, anëtar	
3. Liridon Gashi, anëtar	
4. Adelina Shabandula, anëtare	
5. Sokol Gashi, anëtar	